



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 45/2016

Prishtinë, më 26.1.2016, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Sasha Milosavleviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Flutura Shala dhe Alban Kaciku-MZHE; Dardan Abazi –INDEP; Lekë Batalli–GLPS; Fjolla Uka-KDI; Sylejman Blaku - Kosova Sot; Kushtrim Ahmeti- KTV; Norë Shabani- Koha Ditore; Liridon Llapashtica – Zëri dhe Florina Ejupi-BIRN.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.01.2016;
3. Diskutim lidhur me Raportin e performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2014;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-064 për Patentë shofer;
5. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit të tremujorit të parë për vitin 2016;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa tha se grupi i punës për Projektligjin për Patentë shofer, me ka njoftuar se do ta mbajë një mbledhje që edhe një herë t'i rishikojë amendamentet e projektligjit. Prandaj, propozoi që pika e katërt e rendit të ditës për Shqyrtimin e raportit me amendamente i Projektligjit nr. 05/L-064 për Patentë shofer të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Rendi i ditës u miratua më propozimin e kryetarit.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 14.1.2016

Procesverbali i mbledhjes së datës 14.1.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Diskutim lidhur me Raportin e Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2014

Kryetari i Komisionit, Muhamet Mustafa, i njoftoi anëtarët e Komisionit se shqyrtimin e Raportit të Performances së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2014, e kanë pasur në planin e punës në qershor të vitit 2015, mirëpo për shkak të situatës që ka ndodhur në Njësine për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, kjo pikë ka mbetur deri më tani. Lidhur më këtë ne kemi ftuar përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, për të prezantuar raportin, ushtruesja e drejtorit nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike që është në kuadër të MZHE-së, znj. Flutura Shala, të cilës ia dha fjalën për të paraqitur Raportin.

Flutura Shala, UD- Udhëheqëse e Njesisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, paraqiti Raportin e Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2014 në mënyrë kronologjike për gjitha ndërmarrjet publike dhe kompanitë rajonale veç e veç. Duke i paraqitur të arriturat dhe sfidat më të cilat po përballën këto ndërmarrje dhe kompanitë publike. Ajo tha se sipas nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe Ligjin Nr. 05/L-009, kërkohet që të raportohet në baza vjetore në Kuvendin e Republikës së Kosovës për performancën e Ndërmarrjeve Publike (NP). Znj. Shala theksoi se me qëllim të pasqyrit me të saktë të përfomancës Ndërmarrjeve Publike për vitin 2014, ky raport përmban edhe të dhënat krahasuese ndërmjet vitit 2012, 2013 dhe atij 2014. Tha se ky raport fokusohet në: Performancën operative (rezultatet e arritura, efikasitetin dhe kualitetin e shërbimeve); Performancën financiare (qarkullimin e arritur, efikasitetin e shpenzimeve dhe profitabilitetin); Qeverisjen korporative (monitorimet e punës së Bordeve, llogaridhënien dhe planifikimin i biznesit); Përmbledhjen e raportit dhe Rekomandimet për përmirësimin e qeverisjes korporative dhe performancës së NP. Ky raport e paraqet performancën e sektorit të Ndërmarrjeve Publike nga perspektiva e aksionarëve. Gjatë vitit 2014, në performancën financiare ka një progres, ndonëse jo ai i prituri nga aksionari. Nga shtatëmbëdhjetë NP, në vitin 2014, afarizmin e tyre me bilanc pozitiv-fitim e kanë pasur dhjetë NP, ndërsa shtatë të tjera edhe me tutje vitin e kanë përmbyllur me humbje financiare. Kur i shikojmë individualisht shihet qartë që tri kompani kanë rritur fitimet financiare (KOSTT, KRU

Mitrovica dhe KRU Prishtina); dy kompani kanë arritur t'i shndërrojnë humbjet e vitit paraprak në fitime (KRU Hidroregjioni Jugor-Prizren dhe KRU Hidrodrini-Pejë, ndërsa tri nga to i kanë zvogëluar humbjet e tyre nga viti paraprak (KMDMK, KRU Hidromorava-Gjilan dhe ANP). Fitimet i kanë zvogëluar KEK dhe PTK, ndërsa humbjet i kanë rritur: IL dhe KRU Radoniqi. Për Auditimin e pasqyrave financiare nga Auditori i jashtëm, pasi ZAP ka konfirmuar se nuk do të bëjë auditim të rregullsisë së pasqyrave financiare 2014 te NP, tha se ato janë audituar nga Auditorët e jashtëm të licencuar si kontraktor. Te të gjitha ndërmarrjet ka përfunduar auditimi i jashtëm për vitin 2014. Afati ligjor mbi auditimin e pasqyrave financiare ishte 30 maj. Raportet rezultojnë me opinione mbi përputhshmërinë dhe rregullsinë e pasqyrave financiare, ku kemi opinionet si: tri nga to kanë opinion të pakualifikuar, nëntë nga to të pakualifikuara me theksim çështje, një ka opinion të kualifikuar dhe tri si të kualifikuar me theksim çështjeje dhe një me opinion rezervë. Në krahasim me vitin paraprak, ky është një progres simbolik në opinionet e auditorëve të jashtëm. Për Sektorin e Energjisë, tha se sektori i energjetikës për gjenerim energjie ka një zvogëlim në krahasim me vitin paraprak. Pas aksidentit (më 6 qershor) në TC "Kosova A", njësitë "A4" dhe "A5" nuk kanë operuar në pjesën e mbetur të vitit 2014, ndërsa njësia "A3" ka operuar me performancë mjaft të mirë, pothuajse pa ndërprerje deri në fund të vitit. Ka qenë e planifikuar që njësitë "A4" dhe "A5" të fillojnë operimin në fund të dhjetorit të vitit 2014. Po ashtu edhe nxjerrja e linjtit ka rënie ngase TC "Kosova A" nuk ka punuar një kohë edhe nevoja për thëngjill ka qenë më e vogël. Sektori i Telekomunikacionit, tha se sipas raportit të ARKEP-it për vitin 2014, numri i përdoruesve të telefonisë mobile në Kosovë ka arritur në 1,73 milion apo 95.4% shkallë të penetrimit. Nga këta përdorues, Vala mban 53.4% të tregut sipas përdoruesve, IPKO 36.2% dhe Z- mobile 10.4%. Sipas të hyrave, VALA vazhdon të ketë afër 54% të të hyrave në treg. Sa i përket biznesit të Telekomit, në aspekt të telefonisë fikse, e gjen TK me 95% të hyrave nga zëri. Numri i linjave të internetit me qasje brez gjerë deri në 2014 i raportuar nga operatorët është 190,802 nga i cili numër, TK zotëron 17.7% të tregut të përdoruesve dhe 22.71% të hyrave. Sipas Raportit Vjetor ARKEP-it 2013, pasi ai i 2014 akoma nuk është publikuar, Tregu i përgjithshëm i telekomunikacionit në Kosovë kap vlerën e 228 milionë eurove, pjesën më të madhe të të cilit, apo 75%, e përfshin telefonja mobile, pjesa tjetër mbulohet nga telefonja fikse dhe interneti. Në Kosovë, PTK me të hyra mbulon 65% të telefonisë mobile, 95% të telefonisë fikse. Kjo rënie mund të ketë ndodhur si pasojë e konkurrencës nga operatorët e tjerë në treg, sidomos atyre privatë e të pa licencuar dhe nga mungesa e investimeve të mjaftueshme dhe menaxhimit joadekuat të kompanisë. Për sektorin e ujit të pijshëm tha kemi një progres në disa nga treguesit operativ, pasi inkasimi është me 4% më i madh nga viti paraprak, ndërsa është rritur numri i konsumatorëve për 19,916 konsumatorë të rinj. Pas fillimit të zbatimit të strategjisë mbi reduktimet e humbjeve të ujit prapëseprapë kemi një përqindje të njëjtë si në vitin 2013 në 57 %. Mirëpo, duhet të punohet akoma për të arritur një progres më të madh, pasi që në vitin 2013-2014 kishte edhe indikatorë në rënie, siç ishte prodhimi i ujit, apo edhe qëndrimi konstant i përqindjes së inkasimit të ujit të faturuar përkundër rritjes së numrit të konsumatorëve.

Kryetari i Komisionit, e falënderoi znj. Shala për informatën hyrëse, tha që ky është një raport shumë i rëndësishëm, pasi që ka të bëjë me qeverisjen e ndërmarrjeve publike dhe ky është një raport që përfshihen disa të dhëna. Por, ne konsiderojmë që këtë raport në këtë mënyrë nuk mund ta çojmë në Kuvend, për arsye se i mungojnë shumë informata të kërkuara në periudhë dy-tri javore që të plotësohet me këto gjëra që u përmendën në diskutim. Veçanarisht edhe njëherit po i theksoj se ne patjetër duhet të kemi, të dhëna për Bordet për arsye se Bordet duhet të japin

përgjegjësi në Kuvend. Ligji që e kemi, ndryshimet në Ligjin për Ndërmarrjet Publike e kanë theksuar shumë qartë, ju lutem që të shikoni ato që e theksohet përgjegjësia e Bordit në qoftë se përformanca për dy vite nuk përmirësohet, prandaj ne jemi të detyruar që në Kuvend të raportojmë ato ndërmarrje ku përformanca është rrëzuar, kështu që ne duhet të kemi një informacion të plotë në raport. Te pasqyra financiare ju lutem se për ne është shumë me rëndësi edhe sa është rritur vëllimi i shërbimeve të punëve dhe i prodhimit edhe i shitjeve, por është edhe me rëndësi se si janë menaxhuar, me çfarë ekonomizimi, me çfarë nikoqirllëku janë menaxhuar këto mjete, d.m.th. na interesojnë shpenzimet sipas kategorive, pra ne nuk e kemi listën e pagave, nuk i kemi shpenzimet për shërbimet publike, nuk i kemi shpenzimet për meditje për udhëtime, shpenzimet për bonuse të menaxhmentit dhe bordit, të gjitha këto çështje të cilat duhet të prezentohen në raport. Të aeroporti e theksoi, varet tashti në kontratë është e paraparë që të formohet një Komision i cili ka me përcjellë zbatimin e kontratës, ai Komision a duhet të jetë ndërmnistror apo duhet të jetë në Ministrinë e Zhvillimit dhe ne kërkojmë një raport prej atij Komisioni, d.m.th. se si po zbatohet kontrata e konsesionimit të aeroportit. E gjithë ajo që ne duhet ta bëjmë edhe që Kuvendi duhet ta bëjë është që ne të ngremë mënyrën e monitorimit dhe mënyrën e mbikëqyrjes së funksionimit të ndërmarrjeve publike dhe të bordeve të tyre të ngritim transparencën dhe llogaridhënien kjo është esenciale, kjo është politika e Kuvendit edhe e Qeverisë. Por edhe kërkesa e opinionit sepse këto ndërmarrje kryejnë shërbime me rëndësi vitale për qytetarët dhe ne duhet shohim se si ata që janë emruar nga Qeveria apo nga Kuvendi që të dijmë a po i kryejnë detyrat e tyre edhe menaxhmenti edhe Bordet natyrisht që duhet t'i shikojmë disa ndërmarrje, ndoshta në mënyrë të veçantë masi të marrim raportin e plotësuar. Ne mund të vendosim që të thirrjmë ndonjë në raportim ndonjë ndërmarrje apo Bordin e ndonjë ndërmarrje të caktuar, ndonëse ata i përgjigjen drejtpërdrejt Qeverisë, por ne, si Kuvend, kemi të drejtë që të jemi të informuar për të gjitha çështjet dhe mund t'i japim Qeverisë rekomandime të caktuara lidhur me këto ndërmarrje publike.

Raif Qela tha se mund të shohim se Raporti i Performances së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2014, i ka disa të dhëna të përgjithshme dhe përshtues, por që i mungojnë shumë detaje dhe të dhëna tjera, kur thuhet se kanë rënie në ndërmarrjet publike, por që arsyetimi mungon, pse ka rënie. Lidhur për PTK-në, thuhet se ka rënie të të hyrave të përgjithshme, të përfitimeve edhe vetëm me një arsyetim sipërfaqësor të orientimi të Valës vazhdojnë të ndikohen negativisht nga përdorimi i aplikacioneve papagës përmes internetit që sjellin rënien e të hyrave. Pyeti a ka faktor të tjerë që ndikojnë në rënien e të hyrave dhe të fitimeve në këtë ndërmarrje publike? Ai theksoi se nuk janë cekur edhe disa faktorë të tjerë edhe efekti i atyre faktorëve tjerë në këto rënie të të hyrave edhe fitimeve, as nuk është cekur se çfarë ndikimi ka pasur kontrata me Z-Mobile i cili ia mori një pjesë të tregut, as nuk është përmendur se sa ka ndikuar negativisht dhënia më vonësë e frekuencave shtesë nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, e as nuk është përmendur faktori njeri. Menaxhmenti se sa ka ndikuar në uljen e produktivitetit të punës. Konsideroj se këto arsyeime duhet të jenë të paraqitura për të gjitha ndërmarrjet publike të tregohen arsyet pse ka rënie ose pse ka ngritje, sepse nuk mjafton vetëm konstatim se a ka rënie apo ngritje, por duhet të cekim gjithë faktorët edhe efektet që kanë sjellë këtë gjendje në PTK.

Besim Beqaj tha se Raporti i Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2014, është një përmbledhje e raporteve të ndërmarrjeve publike. Në përgjithësi gjendja në ndërmarrjet publike nuk është e mirë. Është një sfidë për këto ndërmarrje publike, por ka kompani në kuadër të

ndërmarrjeve publike, siç janë dy kompanitë për furnizime më ujë që kanë arritur t'i shndërrojnë humbjet e vitit paraprak në fitime - KRU Hidroregjioni Jugor-Prizren dhe KRU Hidrodrini-Pejë, çka do të thotë se kemi ngritje të kapaciteteve të ndërmarrjeve publike. Po ashtu, edhe mungesa e Bordeve në disa prej ndërmarrjeve publike ka ndikuar negativisht në mos performancën të mirë. Për PTK-në tha që kemi problem, por të cilat duhet të adresohen, siç janë rënia pagesave dhe mos krijimin hapësirës në investime kapitale. Për kontrollin ajror, tha që është shndërruar në një Agjenci të ligjit, por që ka problem të shumta financiare, pasi që ka shumë lëndë në gjykatë lidhur me shpronësimin që i është bërë Aeroportit, edhe ka procedura që më vlera të ndryshme të pagesave është bërë shpronësimi. Për aeroportin, tha që kur është bërë koncesionimi, njësia e cila është paraparë ta bëjë monitorimin, nuk është në kuadër të MZHE-së, por në kuadër të Ministres së Financave. Ai theksoi së raporti e ka adresuar gjendjen siç është, por që ndërmarrjet publike duhet t'i marrin për bazë edhe rekomandimet që ju kanë dhënë nga Auditori për mënyrën e menaxhimit të mjeteve buxhetore. Po ashtu duhet të bëhen pjesë e projekteve të financuara nga donatorët në mënyrë që t'i rrisin kapacitet e tyre duke i fituar projekte që ju takojnë dhe i rrisin shërbimet e ndryshme.

Blerim Grainca tha se Raporti i Performancës së Ndërmarrjeve Publike për vitin 2014, po e shqyrtojmë më vonesë, por besoj që në të ardhmen këto raporte do të sjellën më kohë paraparë nga ministria përkatëse. Ai tha që është shqetësuese performanca kaq e dobtë e disa ndërmarrjeve publike, ku kemi një rënie në aspektin e të hyrave, por jo të disa kompanive. Prandaj ne duhet të ju qasmi kompanive një nga një në shqyrtimin e raporteve, këtë duhet të ja rekomandojmë edhe Kuvendit, sepse nëse një kompani ka pasur performancë pozitive apo negative, atëherë duhet të shohim cili është faktori, a është ai njeri apo vjen prej rrethanave në rrethana në menaxhimin që ju behët këtyre ndërmarrjeve publike.

Besim Beqaj për hir të qartësisht tonë edhe të opinionit, ne nuk është që nuk jemi të kënaqur me raportin, nuk jemi duke e refuzuar raportin, por jemi duke e kërkuar që këto të dhëna të cilat janë në mënyrë komulative të paraqitura këtu, të përcillen me të dhëna të cilat janë më të sakta në kuptimin e të dhënave më të detajume. Sepse raporti është pasqyrim i gjendjes reale të cilën tani e kemi, mirëpo për ta kuptuar që ne, kur shkojmë në Kuvend, para të gjithë deuteve për me e kuptuar edhe vetë ne, po kërkojmë që të kemi sa më shumë detaje, informacione të cilat ainistria dhe qeveria na e sjellin.

Kryetari, sigurisht raporti ka dhenë disa informata, mirëpo këto informata nuk janë të mjaftueshme që ne të nxjerrim konkluzë për performancën e Bordit, d.m.th. raporti nuk na lejon që të shohim se si Bordet e kanë kryer punën dhe ndërmarrjet si kanë funksionuar. Sepse na i mbajmë përgjegjëse Bordet. Bordet nuk mund të fshehen mbrapa një autoriteti që i ka emëruar, por duhet të na tregojnë performancën me tregues të caktuar p.sh ne kërkojmë të ardhurat për një punëtor, shitja për një punëtor me i llogaritë edhe disa tregues, sepse për me e parë performancën duhet me i parë të ardhurat për një punëtor të PTK-së, KEK-ut dhe të ndërmarrjeve të tjera në vitin 2012-2013-2014. Dhe, aty e shohim se sa ka qenë një punëtor produktiv, sa ka kontribuar në rezultate një punëtor në këto ndërmarrje, pagat mandej, se në qoftë se na shohim se shitja për një punëtor ka ra, e paga për një punëtor u rritë ne menjëherë duhet të konstatojmë se aty nuk ka qenë një qeverisje adekuate, pra janë disa çështje që na duhet t'i shohim duhet t'i japim disa çështje indikatorë të caktuar financiar edhe të sasisë së prodhimit dhe të shërbimeve për një punëtorë edhe indikatorë të tjerë, sepse ky raport është për

përformancën. Kështu që na nevojiten më shumë informata, pra një raport shtesë në mënyrë që Kuvendi të ketë një pasqyrë të plotë, e sigurisht pa e neglizhuar që ne kemi edhe këtu disa të dhëna me rëndësi që na japin me konstatuar, por ne kemi përgjegjësi si Komision, në mënyrën se si i trajtojmë raportet dhe se si e informojmë Kuvendin dhe konkluzat të cilat i dërgojmë në Kuvend dhe Qeverisë.

Pas debatit Komisioni njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike përmes Ministrit të Zhvillimit ekonomik, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh të plotësojë Raportin si vijon:

- 1. Çfarë masash kanë ndërmarrë Bordet dhe Qeveria/aksionari në ndërmarrjet që nuk kanë pasur një performancë të mirë dhe në ndërmarrjet ku është keqësuar performanca prej viti në vit në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike; Shembull shpërthimi në “TC KOSOVA A”, çfarë është ndërmarrë për këtë apo çfarë ka bërë Bordi lidhur me rënien e performancës në Telekomunikacion & Vala dhe në Postën e Kosovës?*
- 2. Pasqyra e afizimit financiar të jetë më e mirë dhe të përmbajë detajet e shpenzimeve sipas kategorive për të pasqyruar më mirë menaxhimin me asetet publike. Pasqyrat financiare duhet të plotësohen edhe në kategoritë, siç janë pagat dhe lëvizjen e tyre, pagat për një punëtor, për mediet, për udhëtime zyrtare, shpenzimet për karburante e reprezentacion, pagesat për bonuse eventuale të menaxhmentit dhe të Bordit, kontratat mbi vepër - sidomos për ndërmarrjet kryesore më në detale për ndërmarrjet e tjera mund të jepen sqarime në mënyrë më të përmbledhur;*
- 3. Të saktësohet a është themeluar komisioni për mbikëqyrjen e zbatimit të Kontratës së koncesionimit të Aeroportit Ndërkombëtar “Adem Jashari” dhe të prezantohet ecuria në zbatimin e kontratës dhe përmbushjen e obligimeve nga bartësi i të drejtës për koncesionim;*
- 4. Raporti të plotësohet me një prezantim përmbajtësor të konstatimeve të Auditorit lidhur me lëshimet në ndërmarrjet eaktuara se ku kanë qenë problemet, ku janë shfaqur problemet edhe për kualifikimet më serioze, por edhe kur është fjala për “theksim të çështjes” pse është ky theksim i çështjes?;*
- 5. Raporti duhet të paqyrojë performancën e ndërmarrjeve publike dhe Bordeve të tyre, për performancën me tregues të caktuar si: të ardhurat për një punëtor, shitja (të ardhurat) për një punëtor, fitimi për një punëtor prej viti në vit, si dhe tregues të zakonshëm financiar për një punëtor të PTK-së, KEK-ut dhe të ndërmarrjeve të tjera në vitin 2012-2013-2014;*
- 6. Të jepet një pasqyrë e investimeve që kanë bërë NP-të, me burime të veta të financimit ose me kredi apo nëpërmjet donatorëve;*
- 7. Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP të dërgojë raportin e saj të brendshëm të vlerësimit të Përformancës së Ndërmarrjeve Publike;*
- 8. Të kemi sqarime shtesë lidhur me këto të konstatime në Raportin vjetor si në vijim; në faqen 9, është dhënë numri i mbledhjeve të mbajtura me aksionarin, numri i mbledhjeve të*

mbajtura të Bordeve të Drejtorëve, numri mbledhje të Komisioneve të auditimit, dhe i mbledhje të komiteteve të përkohshme të Bordit – a mund të kemi një informatë të shkurtër lidhur me vendimet kryesore që janë marrë në këto mbledhje; në faqen 10, thuhet “janë organizuar katër takime të Komisionit të Ministrave për NP-të, në të cilat janë diskutuar shumë çështje që kanë të bëjnë me funksionimin e NP-ve” - mirëpo në raport nuk përmenden çështjet e diskutuara, pasqyrimi i çështjeve kryesore të diskutuara dhe vendimet e marra në raport, edhe këtu duhen sqarime shtesë; në faqen 10, thuhet “Janë kthyer në rishikim dy vendime të Bordeve të Drejtorëve mbi përputhshmërinë e të njëjtave me ligjin, respektivisht Vendimi i Bordit të KMDMK mbi miratimin e tarifave për deponimin e mbetjeve shtazore dhe Vendimi i bordit mbi emrimin e KE të Infrakos-it, duhet të njoftohemi rreth mënyrës së zgjidhjes së këtyre dy çështjeve nga Bordet, në procesin e mëtejshëm; në faqen 14 thuhet “Gjatë vitit 2014, sipas tabelës 1, ka një progres të performancës financiare, ndonëse jo ai i prituri nga aksionari” - cilat kanë qenë pritjet e aksionarit?; në faqen 15, janë paraqitur NP-të të cilat kanë dalë me rezultate pozitive, ato të cilat nga rezultatet negative kanë kaluar në rezultate pozitive dhe ato të cilat kanë zvogëluar humbjet – të kemi informim rreth krahasimit të NP-ve të sektorit të njëjtë (p.sh. të sektorit të ujit); në faqen 17, Tabela 4. Faturimi i ujit, inkasimi i ujit, si dhe uji i pafaturuar mbeten ende në nivel jo të kënaqshëm – të kemi sqarime nëse këto janë rrjedhojë edhe e performancës së pamjaftueshme të NP-ve; në faqen 20, thuhet që Qeveria ka mbështetë NP-të për projekte kapitale në vlerë 5.4 milionë euro - nuk sqarohet reflektimi i projekteve kapitale në përmirësimin e performancës së ndërmarrjeve përfituese.

4. Shqyrtimi i Planit të punës së Komisionit të tremujorit të parë për vitin 2016

Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit, se Njësia për mbështetjen e Komisionit ka përgatitur një Plan të punës së Komisionit për tremujorin e parë për vitin 2016, por pasi që tani qeveria e ka sjellë Programin Legjislativ për vitin 2016, kërkoi që ky plan tani të hartohet njëvjeçar duke u bazuar në Programin Legjislativ për vitin 2016.

Me këtë propozim u pajtuan anëtarët Komisionit.

5. Të ndryshme.

Çështje vijuese

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa